

Tony B. Watlington Sr., Ed.D.
Superintendenti

11 Shtator, 2024

Jam i emocionuar të njoftoj se **Proçesi i zgjedhjes së shkollave për vitin shkollor 2025-2026, Gjени përshatshmerinë tuaj, i Drejtorisë Arsimore të Filadelfias hapet këtë të Premte më 13 Shtator 2024 në orën 4:00pm.** Proçesi i zgjedhjes së shkollës, Të Gjени përshatshmerinë tuaj i lejon nxënësit që aktualisht janë në kopshtin parashkollor deri në klasën e 11-të të aplikojnë për të ndjekur çdo shkollë të drejtorisë, me hapësirë të disponueshme, jashtë lagjes ose zonës së tyre për vitin e ardhshëm shkollor. **Aplikacioni do të mbyllet më 23 Tetor 2024 në orën 11:59pm.**

Siç e ndamë muajin e kaluar, ka një sërë ndryshimesh të rëndësishme në proçesin e zgjedhjes së shkollave që Drejtoria vendosi për të konsideruar më mirë preferencën e studentëve, të ofroj më shumë studentë me një ofertë fillestare, të lehtësoj më shumë pranime në një kohë më të shkurtër dhe të rezultoj në një reduktim të përgjithshëm të kohës që do të duhet për të mbushur vendet e hapura nëpër shkollat tona. Ne gjithashtu zbatuam një sistem të ri të zgjedhjes së shkollave, në bashkëpunim me ofruesin tonë të teknologjisë “Avela”, që do të thjeshtojë dhe proçesin e aplikimit. I inkurajoj të gjithë nxënësit dhe familjet që planifikojnë të marrin pjesë në zgjedhjen e shkollës, të rishikojnë [këto përditësime dhe ndryshime](#) para paraqitjes së një aplikacioni.

Përveç këtyre ndryshimeve dhe sistemit tonë të ri, ne kemi planifikuar gjithashtu aktivitete dhe kemi zhvilluar burime të dobishme për t'ju ndihmuar gjatë gjithë kohës se Proçesit të zgjedhjes së shkollës. *Gjени përshatshmerinë tuaj :*

Mësoni më Shumë Rreth Zgjedhjes së Shkollës:

- **Laboratorët e Asistencës së Aplikimit:** Ekipi i zgjedhjes së Shkollës, Të Gjени përshatshmerinë tuaj po ofron Labororë të Ndihmës së Aplikimit në shkollat anembanë qytetit për familjet gjatë periudhes së aplikimit. Ju lutemi vizitoni “ [school selection website](#) “ për orët dhe vendndodhjet e laboratorëve të ardhshëm.
- **Udhëzues për Mënyrat:** Udhëzuesit "How-To-Guides" janë dokumente hap pas hapi që përshkruajnë veprime të ndryshme që familjet duhet të ndërmarrin kur plotësojnë një aplikim në internet. Udhëzuesit mund të gjenden [këtu](#) së shpejti me përkthime në gjuhë.
- **Zgjedhja e Shkollave, Town Halls:** Shikoni zgjedhjen e shkollave në “[town hall recording](#)”, për të mësuar më shumë rreth zgjedhjes së përgjithshme të shkollës dhe proçesit të aplikimit.

Mësoni më Shumë Rreth Shkollave të Mesme me Krite Bazë :

- **Mjeti i Ri i Kërkimit të Shkollës:** Mjeti ynë i ri, i përshatshëm për kërkimin e shkollës, i quajtur [Eksploro](#) ofron informacion të plotë për secilën shkollë.
- **” Open House” për Shkollat e Mesme me Krite Bazë :** Vizitoni shkollat personalisht dhe virtualisht, takoni personelin dhe mësoni më shumë për kulturën e shkollës. Shikoni listën e “Open House” të ardhshme [këtu](#).
- **Panairi i Shkollës Philly:** Panairi i Shkollës K-12 Philly 2024 është një mundësi për studentët dhe familjet që të ndërveprojnë me shkollat dhe programet e disponueshme në qytet, të bëjnë pyetje dhe të

kuptojnë kërkesat dhe afatet e aplikimit. Panairi shërben si një qendër e vetme për shkollat e mesme publike, charter dhe private për të shfaqur materiale promovuese, video, informacione kontakti dhe pas ngjarjeve virtuale të drejtuara nga shkolla. Mësoni më shumë për panairin [këtu](#).

● **Udhëzuesi për Shkollat e Mesme 2025-2026:** [Udhëzuesi për Shkollën e Mesme 2025-2026](#) është gjithashtu i disponueshëm, i cili ofron një listë të plotë të programeve dhe përvojave të ndryshme të shkollave të mesme brenda drejtorisë sonë dhe vendndodhjet e tyre. Studentët mund të kërkojnë udhëzuesin për të gjetur programet akademike, specialitetet shkollore, atletike, jashtëshkollore dhe të karrierës dhe arsimit teknik (CTE) të disponueshme në çdo shkollë të mesme në të gjithë Filadelfian.

Ju ftojme të gjeni përgjigje për pyetjet tuaja shtesë në “[school selection website](#)” Pasi të keni shqyrtuar faqen e internetit, nëse nuk jeni në gjendje të gjeni përgjigjet që ju nevojiten, ju lutemi na kontaktoni përmes platformës sonë të komunikimit të dyanshëm, , [Let's Talk / Le të Bisedojmë](#), duke klikuar skedën Na kontaktoni në fund të faqes së internetit të zgjedhjes së shkollës. Ne kërkojmë durimin tuaj pasi zakonisht përjetojmë më shumë se zakonisht vëllimin e telefonatave dhe emaileve në këtë periudhë të vitit.

Faleminderit që zgjodhët Drejtorinë Arsimore të Filadelfias për arsimimin e fëmijës suaj. Ne mezi presim t'ju mbështesim ju dhe fëmijën tuaj gjatë gjithë kohës së Proçesit të zgjedhjes së shkollave *Gjeni përshatshmërinë tuaj* për vitin shkollor 2025-2026. Ne jemi të përkushtuar të bashkëpunojmë me ju për t'i përgatitur ata të imagjinojnë dhe të realizojnë çdo të ardhme që dëshirojnë.

Në Partneritet,



Tony B. Watlington Sr., Ed.D.
Superintendenti
Drejtoria Arsimore e Filadelfias